VENDIM
Nr.446, datë 16.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE KALIBRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit.

Lista përbëhet nga 30 (tridhjetë) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë dhe i Kalibrimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano